



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.220/09

GJKATA THEMELORE PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me Gjykatësin Bujar Dobërdolani, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit I.Sh.K, nga fshati Ll.E, Komuna e P., tani me vendbanim në P, lagja “D”, nr., të cilin e përfaqëson av. H. P, nga P, rr. “T”, nr., kundër të paditurit H.R nga P, rr. “R.V”, nr., lidhur me çështjen juridike vërtetim pronësie, në shqyrtim gjyqësor me datë 17.04.2018, mori këtë:

AKTGJYKIM NË BAZË TË POHIMIT

- I. APROVOHET padia dhe kërkesëpadija e paditësit I.Sh.K, nga fshati Ll.E, Komuna e P dhe VERTETOHET se paditës ka të drejtën e pronësisë në banesën e cila gjendet në P, Lagja “D”, kati , nr. , evidentuar si njësi kadastrale... lloj i ndërtesës banim, shfrytëzim aktual banesë, me sipërfaqe prej 67.71.m2, e përberë prej 3 dhomave, Zona Kadastrale P, Komuna Kadastrale P.
- II. DETYROHET i padituri H.R, nga P, që paditësit t’ia njoh dhe ta lejoj regjistrimin e kësaj te drejte në Zyren Kadastrale Komunale në P, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e nën kërcimin të përmbarimit me dhunë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditës në padi ka kërkuar që të Vërtetohet se e mbi bazën e kontratës së shitblerjes të lidhur me të paditurin e ka fituar të drejtën e pronësisë ne paluettjshmerin - banesën cila gjendet në P, Lagja “D”, kati , nr., evidentuar si njësi kadastrale ..., lloj i ndërtesës banim, shfrytëzim aktual banesë, me sipërfaqe prej 67.71.m2, e përberë prej 3 dhomave, Zona Kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila aktualisht evidentohet në emër të të paditurit H.R, nga P.

I padituri në përgjigjen në padi, të datës 17.03.2015, si dhe në seancën e datës 17.04.2018, ka deklaruar se nuk e konteston kërkesë-padinë e paditësit dhe e pranon faktin se të njëjti i ka shitur banesën, por meqë është dashur që paraprakisht të bëhet privatizimi i banesës nga i padituri, të njëjtën nuk ka mundur ti bartë paditësit në momentin kur kanë lidhur kontratë mbi shitblerjen e saj me paditësin.

Gjykata pa shqyrtuar më tej ka marr Aktgjykim në bazë të pohimit në mbështetje të nenit 148.1 parag.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Nga të mësipërmet u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 lidhur me nenin 465 të LPK-së, ashtu që secili pjesëmarrës i procedurës i bartë shpenzimet e veta procedurale, pasi me parashtrësën e palës paditëse nuk janë kërkuar shpenzime procedurale pasi që të njëjtat ishin kontestuar nga i padituri.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

C.nr.220/09, dt.17.04.2018

G j y q t a r i
Bujar Dobërdolani

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar e drejta e Ankesës në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate. Ankesa mund të parashtrohet vetëm për shkaqet e parapara në nenin 181.2 të LPK-së